

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE "La RINASCITA" Sh.p.k.

Sot, me date 10/06/2022,

Z. Pasquale Straputicari, shtetas Italian, lindur ne Messina (ME), Itali, me 10/08/1973, banues ne Itali, ne Via Contrada Creti n.1, San Ferdinando (RC), mbajtes i dokumentit Karte Identiteti me nr. AU0017918, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

Ne perputhje me ligjin 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ka vendosur te themeloj nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar te emertuar "La RINASCITA" Sh.p.k. (me poshte referuar si "Shoqeria").

NENI 1

EMERTIMI

Themelohet nje shoqeri e se drejtes shqiptare me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "La RINASCITA" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqerise ndodhet ne: Rruga "Muhamet Gjolllesha", Godina Qendra Tregtare Ring, Hyrja 2, Apartamenti 14, Tirane.

Asambleja e ortakeve mund te themeloje filiale, seli dytesore ose njesi te tjera operative si dhe te transferoje seline e shoqerise ne nje adrese apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise do te jete per nje afat te pacaktuar, pervec zgjatjes ose prishjes se meparshme te saj sipas vendimit te Asamblese se Ortakeve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise:

- Sherbime dhe konsulence per ndermarrjet dhe shoqerite;
- Kultivim bujqesor;
- Ndertimi i vreshtave dhe pemishteve;
- Tregeti me shumice dhe pakice, tregeti online te produkteve ushqimore dhe pijeve;
- Tregti me shumice dhe pakice, Import-Eksport, tregeti online dhe perpunim i produkteve te fruta-perimeve;
- Konsulence Agro-ushqimore;
- Shitje me shumice dhe pakice, tregeti online te makinerive, pajisjeve dhe produkteve per agrokulturen dhe zootekniken;
- Shitje me shumice dhe pakice, tregeti online te produkteve higjenike per shtepine;

- Shitja me pakice dhe shumice, tregeti online te produkteve te paketimit dhe ambalazhimit, transformim/perpunim dhe shitje te materialeve plastike;
- Transport rrugor i mallrave dhe aktivitete te lidhura me te per vete dhe per llogari te te treteve, shperngulje, montime; shit-blerje dhe dhenie me qira e kamioneve, me rimorkio dhe gjysem rimorkio, pajisje per germimin/levizjen/punimin e tokes, ekskavatore, lopata, makina/makineri per shembje te ndertesave dhe makineri te ndryshme;
- Shit-blerje, tregeti online dhe dhenie me qira e makinave, motocikletave, cikletave, varkave, kamperave, karavaneve, ruajtja dhe magazinimi i llojeve te ndryshme produktesh ushqimore dhe jo vetem;
- Shitja me shumice dhe pakice, tregeti online te pjeseve te kembimit per mjetet motorike;
- Projektim, ndertim dhe mirembajtje e kopshteve publike dhe private, ndertim i sistemit te ujitjes dhe veprave te kopshtarise/lulishtarise, shitje te plehrave organike/fertilizanteve, pesticideve, barnave bimore, fungicide, shitje te pajisjeve bujqesore dhe peletit;
- Krasitja ne lartesi dhe prerja e bimeve dhe pemeve te semura/demtuara;
- Marrja persiper e kontratave te prokurimit nga administrata publike dhe nga individet, per ekzekutimin e puneve dhe / ose kontratave per furnizimin e produkteve apo sherbimeve ne lidhje me sa eshte permendur me siper, nepermjet prokurimeve/tenderave, ofertave apo negociatave private.

Pervec kesaj ne perputhje me legjislacionin shqiptar, shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter qe lidhet me objektin e siperpermendur.

Shoqeria ne ushrimin e aktivitetit te saj, do te marre te gjitha autorizimet e lejet/licencat e nevojshme prane institucioneve publike shqiptare, dhe do te mbeshetet ne rregullat dhe normat ne fuqi ne lidhje me ushrimin e veprimtarise se saj te rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar eshte i perbere nga kontributi ne te holla i ortakut te vetem themelues ne vleren 12,000,000 lek (dymbedhjete milion) lek dhe eshte i perbere nga 1 kuote.

Kapitali themeltar ndahet si me poshte:

- **Z. Pasquale Straputicari**, zoteron 1 kuote, me 100% te kapitalit themeltar, me 1 (nje) pjese me vlere 12,000,000 (dymbedhjete milion) lek dhe 12,000,000 (dymbedhjete milion) lek te kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund te zmadhohet nepermjet kontributeve te reja ne para ose ne natyre, sipas vendimeve te asamblese se ortakeve te marra me shumicat te parashikuara per ndryshimin e ketij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQERISE

Organet e shoqerise perbehen nga Asambleja e ortakeve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise e cila vepron ne perputhje me Statutin e shoqerise dhe legjislacionin ne fuqi.
- Asambleja e Pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise.
- **Z. Pasquale Straputicari**, shtetas Italian, lindur ne Messina (ME), Itali, me 10/08/1973, banues ne Itali, ne Via Contrada Creti n.1, San Ferdinando (RC), mbajtes i dokumentit Karte Identiteti me

nr. AU0017918, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar, caktohet Administrator i shoqerise.

- Kohezgjatja e mandatit te Administratorit/eve eshte 5 (pese) vjet, me te drejte ri-emerimi.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHEM

Aktiviteti i shoqerise do te rregullohet nga dispozitat e statutit te shoqerise, si dhe nga te gjitha dispozitat ligjore ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet ne 4 (kater) kopje origjinale ne gjuhen Shqipe dhe ate Italiane me vlere te njeje ligjore.

Permbajtja e Aktit te Themelimit u lexua dhe nenshkrua nga Ortaku themelues i shoqerise duke autorizuar *Administratorin Z. Pasquale Straputicari*, per te kryer te gjitha veprimet e nevojshme per regjistrimin e shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit (QKB) ne Tirane.

**ORTAKU THEMELUES
PASQUALE STRAPUTICARI**

